



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Komunikim ndërkulturor në Gjuhën B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite: (20 leksione, 20 seminare)
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t'i pajisë studentët me aftësitë për të kuptuar dhe për të komunikuar në mënyrë efektive në kontekste ndërkulturore. Përmes studimit të teorive të komunikimit ndërkulturor dhe analizave praktike, studentët do të zhvillojnë aftësi për të identifikuar dhe menaxhuar sfidat që lindin gjatë ndërveprimeve me kultura të ndryshme, duke përmirësuar aftësitë e tyre gjuhësore dhe kulturore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojnë aftësinë për të analizuar ndikimin e kulturës në procesin e komunikimit.
2. Të përvetësojnë teknika për të menaxhuar konfliktet ndërkulturore në mënyrë efektive.
3. Të kuptojnë dhe zbatojnë strategjitë e përshtatjes kulturore në komunikim.
4. Të analizojnë dhe krahasojnë stile të ndryshme të komunikimit verbal dhe joverbal.

Rezultate e pritshme:

1. Identifikojnë dhe analizojnë faktorët kulturorë që ndikojnë në komunikim.
2. Përdorin strategji të avancuara për të menaxhuar sfidat e komunikimit ndërkulturor.
3. Zbatojnë teoritë e mësuara për të zgjidhur probleme reale në komunikimin ndërkulturor.
4. Përshtatin stilin e komunikimit sipas audiencës dhe kontekstit ndërkulturor.